

**LIGJ
PËR AGJENCI OPERATIVE - TEKNIKE**

I. DISPOZITË E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen themelimi i Agjencisë Operative-Teknike (në tekstin e mëtejme: AOT), kompetencat, udhëheqja, të drejtat dhe obligimet e marrëdhënies së punës të punonjësve në AOT, mbikëqyrja profesionale dhe financimi i AOT.

II. KOMPETENCA

Neni 2

(1) AOT themelohet si organ i pavarur dhe autonom shtetëror që do të sigurojë lidhshmëri teknike ndërmjet operatorëve dhe organeve të autorizuara.

(2) AOT vepron si organ ndërmjetësues që vendos kalim teknik ndërmjet operatorit dhe organeve të autorizuara, pa mundësi për aktivizim ose kryerje të incizimit të komunikimeve të ndjekura. AOT nuk posedon mundësi teknike për qasje të përmbajtja e komunikimit të ndjekur.

(3) Lidhshmëria teknike nga paragrafi (1) i këtij neni, sigurohet ekskluzivisht në bazë të urdhrat gjyqësor për kryerje të ndjekjes së komunikimeve në pajtim me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve.

(4) Për kryerje të kompetencës nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, në AOT sigurohen aparate ndërmjetësimi për ndjekjen e komunikimeve.

Neni 3

(1) Për kryerjen e kompetencës nga neni 2 i këtij ligji, AOT aktivizon dhe krijon kushte teknike për ndjekjen e komunikimeve për:

a. hetime penale dhe

b. mbrojtje të interesave për sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit.

(2) Për t'u krijuar kushte teknike nga paragrafi (1) i këtij neni, AOT:

a. mundëson lidhje teknike ndërmjet operatorëve dhe aparatit ndërmjetësues (LEIMD) të instaluar në AOT;

b. mundëson lidhshmëri teknike ndërmjet aparateve teknike (LEIMD dhe LEMF) të vendosura në AOT;

v. mundëson lidhshmëri teknike ndërmjet aparatit teknik (LEMF) të vendosur në AOT dhe stacionet e punës që përdoren për realizimin e ndjekjes së komunikimeve të vendosura në hapësirat e organeve të autorizuara.

(3) Te hapësira memorike e aparatit teknik (LEMF) mund të arrihet vetëm nëpërmjet stacioneve të punës në organet e autorizuara. Përmbajtja e komunikimit të ndjekur në aparatit teknik (LEMF) automatikisht kriptohet.

(4) AOT mundëson mirëmbajtje të aparateve teknike të vendosura në AOT, si dhe vendosje të masave dhe proceseve për shmangie të ndërhyrjeve të

brendshme dhe të jashtme kompjuterike dhe hakerimit, si dhe çdo lloj keqpërdorimi nga ana e të punësuarve në AOT.

(5) AOT kryen mbikëqyrje profesionale në punën e operatorëve.

(6) Mënyrën e kryerjes së punëve nga paragrafi (2) i këtij neni, e përcakton drejtori i AOT (në tekstin e mëtejshëm: drejtori).

III. UDHËHEQJA

Neni 4

(1) Me AOT udhëheq drejtori.

(2) Drejtorin e zgjedh dhe shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve që u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

(3) Për zgjedhje të drejtorit shpallet konkurs publik në së paku dy gazeta ditore, të cilat shtypen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë prej të cilave, njëri prej gazetave që shtypet në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(4) Mandati i drejtorit është pesë vite, pa të drejtë për riemërim.

Neni 5

Drejtor mund të zgjidhet personi që i plotëson kushtet në vijim:

1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;

2) të ketë marrë së paku 240 kredi sipas SETK përkatësisht shkallën VII/1 të arsimit në fushat si vijojnë: informatikë, elektroteknikë, teknikë kompjuterike dhe informatikë, inxhinieri telekomunikimi, siguri, siguri kompjuterike, shkenca juridike ose ekonomike;

3) të ketë së paku dhjetë vite përvojë pune pas mbarimit të arsimit në fushat e parapara në pikën 2) të këtij neni.

Neni 6

(1) Drejtori:

- e përfaqëson AOT,

- organizon dhe siguron kryerje ligjore dhe efikase të punëve dhe detyrave në AOT,

- miraton dispozita për të cilat është i autorizuar në pajtim me ligjin dhe

- kryen punë tjera në kompetencë të AOT në pajtim me ligjin.

(2) Drejtori ka status të personit të autorizuar zyrtar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 7

(1) Drejtori në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dorëzon për shqyrtim raport vjetor për punën AOT për vitin e kaluar kalendarik më së voni deri në fund të muajit shkurt të vitit rjedhës.

(2) Sipas nevojës dhe me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, drejtori dorëzon raporte shtesë.

(3) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni, detyrimisht përmban të dhëna për:

- numrin e komunikimeve të aktivizuara për nevojat e organeve të autorizuar,

- numrin e komunikimeve të aktivizuara për çdo organ të autorizuar veç e veç. Në këtë numër nuk shënohet numri i komunikimeve të aktivizuara për nevojat e sigurisë dhe mbrojtjes,

- gjendjen dhe të dhënat e konstatuara gjatë mbikëqyrjeve të kryera profesionale nga AOT mbi punën e operatorëve,

- numrin e procedurave të zbatuara disiplinore për punonjësit në AOT,

- punën financiare të AOT.

(4) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni, detyrimisht publikohet në vend të dukshëm në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 8

(1) Funkzioni drejtor kryhet në mënyrë profesionale dhe është jokohorent me kryerje të funksionit, profesionit tjetër publik, ose funksionit në parti politike.

(2) Drejtori nuk guxon të marrë pjesë në aktivitete politike dhe ngjarje të cilat sipas llojit dhe karakterit do të mundësonin ekspozimin e tij politik (tubime, mitingje, debate publike).

Neni 9

(1) Funkzioni i drejtorit para skadimit të mandatit pushon sipas këtyre bazave:

- me kërkesë të tij,

- nëse përgjithmonë e humb aftësinë për kryerje të funksionit,

- nëse i ka plotësuar kushtet për pension pleqërie në pajtim me ligjin,

- nëse është gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale e cila e bën të padenjë për kryerjen e funksionit.

(2) Baza për shkarkim të drejtorit para skadimit të mandatit janë:

- nëse në raportet të cilat trupat mbikëqyrës dhe kontrollues në pajtim me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve i parashtrojnë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, konstatohet kryerje e paligjshme e punëve në kompetencë të AOT,

- nëse e pengon kontrollin dhe mbikëqyrjen e organeve kompetente të theksuara në Ligjin për ndjekjen e komunikimeve,

- nëse nuk vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit,

- keqpërdorim i pozitës dhe autorizimeve zyrtare,

- shkelje të sigurisë së informatave të klasifikuara,

- keqpërdorim të të dhënave personale.

IV. TË DREJTA DHE OBLIGIME TË MARRËDHËNIES SË PUNËS

1. Themelimi i marrëdhënies së punës

Neni 10

Të drejtat dhe obligimet e marrëdhënies së punës, punëtorët në AOT i realizojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, rregullat nga fusha e marrëdhënies të punës dhe marrëveshjes kolektive.

Neni 11

(1) Në AOT punëtorët kanë status të:

- personave të autorizuar zyrtarë, në pajtim me këtë ligj dhe
- punëtorëve në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet e punës.

(2) Punëtorëve me status të personave të autorizuar zyrtarë, AOT u lëshon legjitimacion të veçantë zyrtar.

(3) Formën dhe dukjen e legjitimacionit zyrtar nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe mënyrën e lëshimit të tij i përcakton drejtori.

Neni 12

(1) Punëtorët nga neni 11 alineja 1 e këtij ligji, kanë obligime dhe autorizime të veçanta të përcaktuara me këtë ligj, për shkak të shkallës së lartë të besueshmërisë, llojit dhe kompleksitetit të punës.

(2) Me aktin për sistematizim të vendeve të punës në AOT përcaktohen vendet e punës me obligime dhe autorizime të veçanta.

Neni 13

Vendet e punës të punëtorëve nga neni 11 i këtij ligji, grupohen në mënyrën si vijon:

1. Grupi I – punëtorë udhëheqës:
 - këshilltar shtetëror;
 - udhëheqës i sektorit;
 - udhëheqës i seksionit.
2. Grupi II – punëtorë profesionalë:
 - këshilltar kryesor;
 - këshilltar i pavarur;
 - këshilltar i lartë;
 - këshilltar i ri.
3. Grupi III – punëtorë operativë-teknikë:
 - punëtor kryesor operativ;
 - punëtor operativ i pavarur;
 - punëtor operativ i lartë dhe

- punëtor operativ i ri.

Neni 14

Drejtori i miraton aktet për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës në AOT.

Neni 15

Personave të autorizuar zyrtarë në AOT, stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të zmadhuar dhe atë çdo 12 muaj të kaluar në mënyrë efektive në ato detyra llogariten si 16 muaj stazh të sigurimit.

Neni 16

(1) Marrëdhënie të punës të punëtorëve të autorizuar në AOT mund të themelojë person i cili i plotëson kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të jetë i moshës madhore,
- të jetë i aftë me shëndet dhe psikofizikisht,
- të ketë mbaruar së paku arsim të mesëm katërvjeçar,
- me kontroll sigurie të jetë konstatuar se nuk ekziston rrezik sigurie nga punësimi i personit dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalim për kryerje profesioni, veprimtarie ose detyre.

(2) Krahas kushteve të përgjithshme për themelim të marrëdhënies së punës nga paragrafi (1) i këtij neni, me aktin për sistematizim të vendeve të punës në AOT, mund të përcaktohen edhe kushte tjera të veçanta.

Neni 17

(1) Me kërkesë të drejtorit ose personit të caktuar prej tij, kryhet kontroll sigurie i personit para themelimit të marrëdhënies së punës në AOT për përcaktim të rrezikut të sigurisë sipas ligjit.

(2) Kontrolli i sigurisë nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet në bazë të pajtimit paraprak me shkrim të personit.

(3) Për personin i cili refuzon kontrollin e sigurisë konsiderohet se nuk i plotëson kushtet për themelim të marrëdhënies së punës në AOT.

(4) Kontrolli i sigurisë i personit kryhet si kontroll sigurie i shkallës së dytë, në pajtim me dispozitat nga fusha e informatave të klasifikuara.

(5) Me kontrollin e sigurisë merren të dhëna drejtpërdrejt nga personi, për të cilin kanë të bëjnë ato, nga persona tjerë, organe shtetërore, ndërmarrje, institucione publike dhe persona tjerë juridikë, në pajtim me ligjin.

(6) Organet kompetente për kontrollin e sigurisë janë të obliguar të përfundojnë procedurën për kontroll dhe në mënyrë përkatëse ta informojnë drejtorin në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës së përmendur në paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 18

Marrëdhënie pune në AOT themelohet në bazë të konkursit publik, me kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitat nga fusha e marrëdhënieve të punës.

Neni 19

(1) Konkursi publik për themelim të marrëdhënies së punës në AOT publikohet në faqen e internetit të AOT, si dhe në së paku dy gazeta ditore, të cilat shtypen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë prej të cilave, njëren prej gazetave që shtypet në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(2) Në konkursin publik shënohet vendi i punës dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për themelim të marrëdhënies së punës.

(3) Afati për paraqitje në konkursin publik nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk mund të jetë më pak se 15 ditë përkatësisht më shumë se 20 ditë nga dita e publikimit të tij në mediet e shtypit ditor.

Neni 20

(1) Me përjashtim të nenit 18 të këtij ligji, marrëdhënie pune pa konkurs publik në AOT mund të themelohet për vende pune, të cilat në aktin për sistematizim të vendeve të punës janë të përcaktuara me status - persona të autorizuar zyrtarë.

(2) Personi që themelon marrëdhënie të punës në AOT pa konkurs publik, detyrimisht duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me ligj dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(3) Për çdo marrëdhënie të themeluar pune në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, drejtori detyrimisht e njofton Komisionin për mbikëqyrje të zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e themelimit të marrëdhënies së punës së punonjësit.

2. Paga dhe kompensime të pagës

2.1. Paga dhe komponentë të pagës

Neni 21

(1) Punëtori në AOT ka të drejtë page dhe kompensim për pagë, në pajtim me ligjin, marrëveshjen kolektive dhe marrëveshjen për punësim.

(2) Paga punëtorit i sigurohet nga mjetet e AOT.

(3) Pagesat nga paragrafi (1) i këtij neni realizohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat nga fusha e marrëdhënieve të punës.

Neni 22

Paga e punëtorit në AOT përbëhet prej:

- pagës themelore dhe

- rritjes për 30% për punëtorët me status të personave të autorizuar zyrtarë.

Neni 23

(1) Paga themelore përcaktohet në bazë të statusit të punëtorit të përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji, përkatësisht në bazë të grupit në të cilin bën pjesë vendi i punës së punëtorit në pajtim me nenin 13 të këtij ligji.

(2) Punëtorët në AOT me status të nëpunësve të autorizuar kanë të drejtën për pagë themelore që dallohet varësisht se në cilin nga tre grupet bën pjesë punëtori në pajtim me nenin 13 të këtij ligji.

(3) Personave të autorizuar zyrtar nga Grupi I – punëtorë udhëheqës, u caktohen pikët për pagë themelore në shumë prej:

- këshilltar shtetëror – 1100 pikë,
- udhëheqës i sektorit – 1050 pikë dhe
- udhëheqësi i seksionit – 1000 pikë.

(4) Personave të autorizuar zyrtarë nga Grupi II - punëtorë profesionalë, pikët për pagë themelore u përcaktohen në shumë prej:

- këshilltar kryesor – 900 pikë,
- këshilltar i pavarur – 850 pikë,
- këshilltar i lartë – 800 pikë dhe
- këshilltar i ri – 750 pikë.

(5) Personave të autorizuar zyrtar nga Grupi III - punëtorë operativo-teknikë, pikët për pagë themelore u përcaktohen në shumë prej:

- punëtor kryesor operativ – 650 pikë,
- punëtor i pavarur operativ – 600 pikë,
- punëtor i lartë operativ – 550 pikë dhe
- punëtor i ri operativ – 500 pikë.

(6) Në aktin për sistematizim të vendeve të punës, saktësisht përcaktohet numri i personave të autorizuar zyrtarë dhe punëtorëve në pajtim me Ligjin për marrëdhënie të punës, në secilin prej grupeve të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji.

(7) Përvoja e punës vlerësohet në vlerë prej 0,5% të pagës themelore të përcaktuar për vendin e punës, për çdo vit të filluar stazh sigurimi, e më së shumti 20%.

Neni 24

Duke pasur parasysh shkallën e lartë të besueshmërisë dhe llojit të punës si dhe procesit më rigoroz të seleksionimit dhe duke pasur parasysh rregullat dhe obligimet rigorozë, personat e autorizuar zyrtarë në AOT marrin rrogë më të lartë për 30% nga rroga themelore e punonjësit të përcaktuar në nenin 23 të këtij ligji.

Neni 25

(1) Vlerën e pikës për llogaritje të pagave të punëtorëve në AOT e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në kuadër të mjeteve të përcaktuara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Vlera e pikës nga paragrafi (1) i këtij neni korrigjohet përkatësisht harmonizohet nëse sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë rritja mujore e shpenzimeve për jetesë është mbi 5% në tre muajt e fundit, nëse janë siguruar mjete në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

2.2 Kompensime për pagë

Neni 26

Punëtorit në AOT i takojnë kompensime për pagë për:

- pushim vjetor,
- festa të përcaktuara me ligj ose dispozitë tjetër,
- mungesë për shkak të shtatzënisë, lindjes së fëmijës dhe amësisë,
- përkujdesje të fëmijës,
- trajnim,
- paraqitje në ftesa të organeve tjera që kanë ardhur pa fajin e punëtorit dhe
- në raste tjera të përcaktuara me ligj dhe marrëveshje kolektive.

Neni 27

(1) Gjatë kohës së paaftësisë së përkohshme për punë deri në shtatë ditë, punëtori në AOT ka të drejtë kompensimi për pagë në lartësi prej 70%, deri në 15 ditë duke filluar nga dita e parë e pushimit mjekësor - kompensim për pagë në lartësi prej 80% dhe deri në 30 ditë për të gjitha ditët – kompensim të pagës në lartësi prej 90%.

(2) Për sëmundje profesionale dhe lëndime në punë dhe për raste tjera të përcaktuara me ligj, kompensimi për pagë përcaktohet në lartësi prej 100%.

(3) Punëtorit në AOT me status të personit të autorizuar zyrtar vetëm në rastet gjatë paaftësisë personale për punë (sëmundje) ose lëndimit në punë i paguhet kompensim për pagë në lartësi të pagës të punëtorit të përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji.

(4) Bazë për llogaritje të kompensimeve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni është paga themelore e punëtorit e përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji, të paguar në muajin e kaluar para fillimit të mungesës.

Neni 28

Për të gjitha çështjet që rezultojnë nga marrëdhënia e punës a punëtorëve në AOT në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e përgjithshme të marrëdhënieve të punës dhe marrëveshjes kolektive.

3. Ndërprerja e marrëveshjes për punësim me vitet e kryera të stazhit pensional

Neni 29

(1) Marrëveshja për punësim e punëtorit në AOT me status të personit të autorizuar zyrtar ndërpritet me fuqi të ligjit, pasi mbarimit të 40 viteve stazhi

pensional, pa marrë parasysh vitet e tij të moshës.

(2) Punëtori nga paragrafi (1) i këtij neni e realizon të drejtën e pensionit të pleqërisë që përcaktohet në lartësi prej 80% nga neto paga mujore mesatare të cilën punëtori e ka realizuar gjatë dhjetë viteve më të volitshme të stazhit pensional.

(3) Punëtorit të cilit i është ndërprerë marrëveshja për punësim në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, i takon kompensim i njëfishtë në formë pagesës përcjellëse, në lartësi prej pesë neto pagave mujore mesatare të realizuara për punëtor në Republikën e Maqedonisë, të publikuar deri në ditën e pagesës.

(4) Punëtori nga paragrafi (1) i këtij neni, me deklaratë të shkruar në AOT mund të kërkojë t'i vazhdohet marrëveshja për punësim më së shumti deri në mbarimin e 45 viteve stazhi pensional, pa marrë parasysh vitet e moshës së tij.

(5) Deklaratën me shkrim nga paragrafi (4) i këtij neni, punëtori e dorëzon më së voni deri më 31 gusht të vitit rrjedhës për vazhdim të marrëveshjes për punësim nga paragrafi (4) i këtij neni, e për çdo vazhdim të mëtutjeshëm të marrëveshjes për punësim nga paragrafi (4) i këtij neni, deklaratën e jep një herë në vit, e më së voni deri më 31 gusht në vitin rrjedhës për vazhdimin e marrëveshjes për punësim për vitin e ardhshëm.

(6) AOT është e obliguar pas deklaratës së dhënë nga paragrafi (4) i këtij neni, ta vazhdojë marrëveshjen për punësim më së shumti deri në mbarimin e 45 viteve stazhi pensional të punëtorit, pa marrë parasysh vitet e moshës së tij.

(7) Pensioni i pleqërisë nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet në lartësi prej 80% të neto pagës mujore mesatare të cilën punëtori e ka realizuar gjatë dhjetë viteve më të volitshme të stazhit pensional.

4. Ndërprerja e marrëveshjes për punësim

Neni 30

Marrëveshja për punësim e punëtorit në AOT ndërpritet:

- për shkak të keqpërdorimit të të dhënave personale në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale,
- nëse punëtori nuk vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit.

5. Besueshmëria

Neni 31

Drejtori dhe punonjësit në AOT janë të obliguar t'i ruajnë si sekret të dhënat të cilat i kanë marrë në punën e tyre, jo vetëm gjatë kohës së mandatit, përkatësisht punësimit në AOT, por edhe pesë vite pas skadimit të tij, përkatësisht ndërprerjes së punësimit, që veçanërisht ka të bëjë për të dhënat personale ose informatat e klasifikuara në pajtim me ligjin.

V. MBIKËQYRJA PROFESIONALE

Neni 32

(1) Për kryerje të mbikëqyrjes profesionale të punës së operatorëve, drejtori nga radhët e punëtorëve në AOT formon Komision për mbikëqyrje profesionale (në tekstin e mëtejme: Komisioni) që përbëhet prej kryetarit dhe dy anëtarëve.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, kryen mbikëqyrje mbi përdorimin e pajisjes teknike dhe përçuesve elektronikë të komunikimeve që shërbejnë për lidhjen e AOT dhe operatorit.

(3) Pas mbikëqyrjes së kryer, Komisioni përpilon Raport për punën e operatorit në të cilin përmbahen sugjerime për punën e operatorit në lidhje me gjendjen dhe përdorimin e pajisjes teknike dhe përçuesve elektronikë të komunikimeve që shërbejnë për lidhjen e AOT-së dhe operatorit.

(4) Komisioni e parashton Raportin nga paragrafi (3) i këtij neni te operatorit në afat prej tri ditësh pas zbatimit të mbikëqyrjes.

(5) Raporti nga paragrafi (3) i këtij neni, dorëzohet në Komisionin për mbikëqyrje të zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve në Kuvendin e Republikën e Maqedonisë, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe në Agjencinë për Komunikime Elektronike, për informim.

(6) Operatori është i obliguar që pa prolongim të veprojë sipas të dhënave dhe sugjerimeve të Komisionit të paraqitura në Raport.

VI. FINANCIMI

Neni 33

Mjetet e pagës, kompensimet dhe shtesat e pagës, për punë, avancim, modernizim dhe pajisje të AOT, si dhe për stimulim të punëtorëve në AOT, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 34

(1) Procedura për zgjedhje të drejtorit do të fillojë në afat prej dhjetë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Aktet për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës në AOT, do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e zgjedhjes së drejtorit.

(3) Procedura për punësim të personelit në AOT fillon në afat prej shtatë ditësh nga dita e zgjedhjes së drejtorit.

(4) Dispozitat nënligjore të parapara në pajtim me dispozitat e këtij ligji, do të miratohen në afat prej 90 ditësh nga dita e zgjedhjes së drejtorit.

Neni 35

(1) Me qëllim të themelimit dhe vendosjes së AOT, Qeveria e Republikës së Maqedonisë siguron pronë të tundshme dhe të patundshme dhe siguron që aparatet teknike (LEIMD dhe LEMF) për ndjekjen e komunikimeve, si dhe dokumentacioni teknik të barten nga Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim në AOT deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

(2) Aparatet e ndërmjetësimit për ndjekjen e komunikimeve të cilat janë në pronësi të operatorëve, e të cilat i përdor Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim, barten në AOT deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

(3) Në funksion të fillimit efektiv dhe mundësimit të ndjekjes së komunikimeve, AOT e sapothemeluar mund të marrë punëtorë nga Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim me pajtim të tyre në vendet e punës që përputhen me përgatitjen profesionale përkatësisht kualifikimet e tyre.

(4) Punëtorët të cilët merren në AOT në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, janë persona të cilët kanë përvojë në përdorim me aparatet teknike për qëllimet e ndjekjes së komunikimeve dhe numri i tyre nuk mund të jetë më tepër se shtatë.

Neni 36

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, përveç dispozitës së nenit 3 të këtij ligji që do të fillojë të zbatohet më së voni deri më 1 nëntor 2018.